08-2

ASEM KAVAEV

DASMA NË KOOPERATIVË

PIÈCE THÉATRALE

SHTYPSHKRONJA „GOCE DELČEV" — SHKUP

1951

ASEN KAVAEV

Dasma ne kolektiv

PJESE TEATRALE NE NJI AKT

BOTON: SIPERMARJA BOTUESE E LIBRAVE „ILINDEN"

PERKTHYEM NGA MYRTEZA R. PEZA

P E R S O N A T

DAMJAN katundar i vorfen, 45 vjeç
RISTENA, e shoqja, 38 vjeç
SLLAVJANKA, e bija e tyne, 18 vjeç
MARIJA, motra e Ristenes, 50 vjeç
STOJAN, burri i Marijes, katundar i pasun, 55 vjeç
VOJDAN, dhandri
KRYETARI i kolektivit, 30 vjeç
KUMI, 40 vjeç
BYRAZERI
KUNATI
NDERMJETSI
VJEHRRA
GLIGURI, karrocjer
PERE

Vajza, djem, katundare e kautndarka, femije.

Katundi asht ne nji fushe te bukur. Nji dhome e madhe ne nji shtepi te vorfen katundare. Ne anen e majte gjindet porta dhe dritarja nga ana e rruges.

Ne anen tjeter gjindet nji porte qe lidh dhomen me pjeset e tjera te shtepise Afer portes gjindet votra katundare me streh te madh. Prej votres ne te djathte jane venduem shqembe per t'u ulun. Ne numrin e djahte jane vendosun dy

masa njena prane tjetres. Ata nuk jane njisoj. Ne masen e pare ka shishe me raki, vene dhe nji t'abaka plot me gota rakije dhe vene.

Rreth masavet karrike e shqembe te ndryshem — te mbledhun neper fqinjet.

Mbi oxhakun jane vendosun tufa lulesh.

Dyshemeja asht mbuluem me hasra (rrogoze) dhe mbi hastar asht shtruem nji qebe e vogel.

Ristena dhe Sllavjanka jane tue rregulluem diçka neper sandyqet. N'anen e majte gjindet nji minder i gjate i mbuluem me qebe (betanija).

Prane sandyqevet asht shtruem nji qebe e vogel dhe mbi te asht vendosun nji sofer e vogel dhe e ulet.

Ristena rregullon qeben dhe jastuket prane murit. Sllavjanka merr prej masavet nji vaze balte me lule dhe e vendos mbi oxhakun.

Kohe e tashme. Pranvere. Nji katund prane Vardarit.

SLLAVJANKA: (Tue vendosun lule mbi axhakun. Ne dritaren kah rruga ndigjohet nji za:... Sllavjanko...)

SLLAVJANKA: Nane, — po vjen tezja!

RISTENA: (E çuditun dhe e gezueme) — Vrapo t'i hapesh porten! (Sllavjanka hap porten. Hyne e motra e Ristenes — Marija. Ne dore mbane nji tabaka me gota rakije te mbuluem me nji shamije, ne doren tjeter ka nji shishe plot me raki, gjithashtu te mbulueme me shami. Qysh prej deres flet):

MARIJA: A jeni gjuem? ... Mire mengjez ...

SLLAVJANKA: Po teze jemi ngritun. Urdhno.

MARIJA (Zbulon tabakan): — Ja ju pruna gota... (Tabakan ia jep Sllavjankes)... Por kij kujdes... Ne dasem... mund te thyhen...

SLLAVJANKA: (Te faleminderes teze. . .) i vendos ne masen tjeter.).

RISTENA: Mire se erdhe moter. . .

MARIJA: Mire se te gjeta. . . Na merri ti kete. . . Raki. . . Zbraze dhe me kthe shishen. . .

RISTENA: Te faleminderes moter. Pse je mundue?.. Sllavianko zbraze shishen. . . Hajde Marrija. . . Ulu. . .

MARIJA: (Hecen dy tri hapa, shef masat e rregullueme dhe karriket, por nuk ulet):. . Shka ju duhesh tashti kjo. . . Sa mire na shkojshin burrat, kurse tashti krejt ndryshe. . . (qane) une erdha msheftazi. . .

RISTENA: Pse qane?. . . Un jam ne pike te hallit dhe nuk qaje. . Po ti pse qane?. . .

MARIJA: Te kishit pritun edhe pak. . . Edhe ti je fajtore! Vajzes do t'i dilte fat edhe ma i mire. . . Tashti shka?

RISTENA: E tashti mbaroi ajo pune. . Dashunohen. . . Edhe per djalin s'kam se shka te them. Edhe ti e din se te gjithe e lavderojne.

MARIJA: E lavderojne, por nuk ka kurrgja. . .

RISTENA Nuk ka, po tashti a nuk asht ne kolektiv?. . . Kemi shprese ke zoti se do te rregullohen edhe ata edhe neve. . .

MARIJA: E jueja u pa ma, — por per Sllavjanken. . E kam dashtun dhe perkedhelun tamam si femine t'ime (prap meshine lotet). . . Kurse tashti nuk mundem te vij as ne dasem. . .

RISTENA (e prekun) — uh-uh — moter. Hajde mos me ban te qaje edhe un. . . (pushim i shkurten. . . te dyja meshijne lotet).

MARIJA: Ti kishje folun Damjanit. . . Te zbutet edhe ai. . . Te vij ne shtepi. . . Ta lusi edhe njihere ate t'onin. . .

RISTENA: Ti mendon se nuk i kam folun?. . .

MARIJA: a nuk asht ma i vogel... ta plasi djallin dhe te pajtohen...

RISTENA: Nuk asht puna e djallit. Per at pune Dame asht gati... edhe doren do t'i puthte. Stojanit po t'ishte nevoja ...Po ketu asht nji çeshtje tjeter...

MARIJA: Kolektivi i juej i mallkuem... Ai i ngatarroi te gjitha punet. Tashti nuk mund te miren vesht as vllau me vllaun... Edhe Dame asht njisoj si te tjeter... edhe ai asht fajtore.

RISTENA: Mos u idhno me Damen... ai nuk ka asnji faj...

MARIJA: Mos te ja bante qejfin te tjervet.

RISTENA: Marija, a nuk asht edhe ai njeri?... A gjithnji poljak te mbetet?.. Dhe pse?... Per nji buke te mbledhun neper njiqind shtepija...

MARIJA: Prap jetojshit...

RISTENA: Jetojshim... Ti e din shum mire se si e kishim hallin, kur bashke me te shkojshim shtepi ne shtepi per me mbledhun hakun. . Po ja, qysh kur kemi hy ne kolektiv — asht krejt ndryshe.... Tashti kemi edhe emen tjeter...

MARIJA: E dij moj moter e dashtun. Por me thuej shka te baj une?.. A te vritem a?... Duhet te mendoj edhe per ju, dhe n'ane tjeter te duroj edhe inatet e atij....

(Sllavjanka vjen prej mbrenda dhe ne dore ka shishen e tezes bosh, ne doren tjeter ka shishen e mbushun dhe e ven ne masen afer gotavet).

SLLAVJANKA: Urdhno teze...

(Marija merr shishen, por ja jep Ristenes, prej gjijvet qit dishka te mbledhun ne shamije... Deri sa e qit prej gjijve dhe e hap ajo qane gjithnji):

MARIJA: Ta kam dashtun si bijen t'ime... Pse mue zoti nuk me dha femije... (e perqafon Sllavjanken)... Eh si e kam pritun kete dite... Dhe ja tashti te mos mundem te vij as ne dasem...

(Prej shamis qit nji flori te madh, pes lirash me nji kordhel te kuq dhe ja mvaren ne qafe Sllavjankes). Na... ja. Kete e ke prej meje... Çdo gja e kemi do t'ishte e jotja... Por shka te baj tashti, kur ne shtepi u nderruen krejt punet... Ai nuk te lejon asnji fjale te thuesh, e jo ma te japim diçka. (kur ja mvare ne qafe terhiqet pak mbrapa dhe meshine lotet. Sllavjanka i puth doren).

SLLAVJANKA: Te faleminderes shum Teze... (e gezueme shume, ajo e prek dhe shikon pes-lirshin).

RISTENA: Ska gja moj moter... Edhe kjo do te kaloje. Mundet edhe keshtu.

MARIJA: (Merr prej Ristenes shishesh dhe e mbledh me shami).

Shka bate me jorganin?...

RISTENA: Kurrgja... Lesh nuk gjetem... Do ta martojme me nji jorgan...

MARIJA (don te hiki po lotet i rrjedhin gjithnji).

RISTENA: Hajde... mos ban keshtu... Ti ne vend qe te me japish zemer, po duhet un te te flas dhe te qetsoj...

MARIJA: Pse per keshtu kemi menduem...

SLLAVJANKA: Teze, nuk kam nevoje per kurrgja... Mos te te vij keq hic... Me mjafton ky pes-lirshi... (e perqafon nga shpatullat)... E dij se ma jep me gjithe zemer dhe do t'a ruej me gjithe zemer...

MARIJA (meshine lotet, e shikon me mallengjim dhe i nenqesh)...

SLLAVJANKA: Dhe ti mos e ndigjo dajen... Hajde. Te due edhe ty. Edhe ti te me shofish si nuse... A? A do te vijsh?...

MARIJA: Do te mundohem t'a zbusi moj bije e dashtun...

SLLAVJANKA: Shif sa ma shpejt, pse ata do te vijne tash...

MARIJA: Uuu... a kaq heret a?...

SLLAVJANKA: Heret... Do te shkojme ne Novo-sello.

MARIJA: Pse a ne kishen e atjeshme?

SLLAVJANKA: Do te shkojme miq ne kolektivin e atyre. Atje do ta bajme dasmen.

RISTENA: Jane shoke te dhandrit... edhe e duen te shkojne atje... Paskan pregatitun nji pritje te madhe...

MARIJA: (E perkedhel) Gezohem shum moj bije e dashtun... Me fat te bardhe te me nisesh... Hajde un po shkoj (Marija niset te shkoje).

SLLAVJANKA: Teze do te te pres... Ta dijshe...

DAMJANI: (hyne prej deres se mbrendeshme): o-oo, Marije. Pse nuk me treguet se Marija paska ardhun?...

RISTENA: Ajo erdhi shpejt e shpejt...

SLLAVJANKA: (I tregon pes-lirshin) Shife shka me prue...

DAMJANI: Ehe, hajt me hajer ta mbajshe... Mundesh edhe pa ate... Bija e poljakut mund te bahet nuse edhe pa pes-lirshe...

MARIJA: Hajt tashti mos fol keshtu... Tash ma nuk je poljak a po jo...?

DAMJANI: Jo nuk jam. Por simbas Stojanit t'and jam gjithnji poljak... Hajt mire se na erdhe... Si te ka lejuem te vijsh ketu... Si i asht shkeputun prej zemres peslirshi?... Apo ti e ke prum mesheftazi pa dijtun ai gja?

MARIJA: Peslirshi asht i jemi... Dhe tashti asht i Sllavjankes...

DAMJANI: Atehere asht ndryshe puna... Edhe un te te falenderoj. Per ndryshe nuk due ta ndegjoj deri sa te jeme gjalle se i ka dhuruem peslirshe vajzes t'ime...

MARIJA: Sa i keq je edhe ti..! Si jeni bamun te gjithe .. As nguceni as e duroni njeni tjetrin... Kurse neve te shkretat i hjekim te gjitha...

DAMJANI: Marije na jemi te mire, por e shkreta pasuni e tij nuk e len rehate... I ka hye shum ne zemer, dhe nuk don as zemren e vet t'a zbuloi se mos i shifet se shka ka mbrenda.

MARIJA: Eh...

DAMJANI: Eh!... E pse ti flasish? Asht bamun ma si grenze... Asht idhnue e inatosun... E gjithe bota asht fajtore per te. Po me shif mue — jam kuq kuq dhe i ri sikur te kishje 25 vjeç...

MARIJA: Po shka mund te baj une?.. Ata mblidhen çdo dite... Edhe sidomos ai — prej mehalles se eprme — Bilbili — ai asht ay qe ja mbush ma teper mendjen...

DAMJANI: Le ta ndegjoi!.. Te shofim se deri ku do te shkojne keshtu...Mue nuk me ndegjoi — jam poljak!... Kurse Bilbili asht i pasun — dhe mendjen e ka ma te madhe

MARIJA: Eh kete e keni shkaktuem ju me kete kolektivin t'ue... E ngatarruet te gjithe katundin...

DAMJANI: Marije, ti se pakut nuk je me zemren e tyne!...

MARIJA: Nuk jam, por ha de!... Qysh kur u themelue kolektivi e gjithe puna ndryshoi.

DAMJANI: Shka ndryshoi?.. Pse a ma keq jemi tashti? (Marija heshten).. a po nuk shef se prej dy vjetesh e kendej ketu ke neve asht ma ndryshe?..;. Dhe nuk i lutemi askujt... Asnjihere nuk vuejme prej urije... Emen tjeter kemi... Dhe nuk i lutemi askujt... Por çfar lypsish ishim ma perpara e mbane mend? Turp me vinte prej Ristenes ta terhek prej lame ne lame me thes ne kraha... Kurse tashti jam edhe un njeri si gjithe te tjeret... Nuk turpnohem prej askujt — tash edhe shpirti me kendon!...

MARIJA: Ashtu qoft mor dhander... Edhe un gezohem ... Vetem me duket se u ngutet pak per Sllavjanken... Te me pyetshit edhe mue...

DAMJANI: Nuk kemi gabuem aspak, Marije. Djali asht i mire... Kam shprese se do te jene te lumtun...

MARIJA: Eh. porse thue edhe ti keshtu... atehere qofshin te lumtun dhe me fat te bardhe...

(pershendetet edhe shkon).

DAMJANI: A nuk do te vijsh perseri?.. Hajde!... Mos e ndigjo at grethin... Kemi jetuem aq mire. — hajde edhe tashti, kur kemi kete gezim kaq te madh...

MARIJA: Do te mundohem ta zbus edhe pak... Hajt mbetshit me shendet...

DAMJANI DHE RISTENA: Shendet patsh dhe mire ardhsh Marije... (e percellin. Sllavjanka shkon kah zjarri dhe shikohet ne nji pasqyre te vogel, tue mbajt florinin me dore).

RISTENA: Sllavjanka ma jep ta shof ate peshirshin..

SLLAVJANKA: Tezja ka zemer te mire, por daja asht nji...

RISTENA: E plasi me hyqet dhe inatin e tij, do ta thaje si token vapa...

DAMJANI: Nuk ka per ta thamun, pse edhe koka e tij do te kthjellohet shpejt... Kane mbetun vetem dhet prej tyne.

RISTENA: Ti mos e ndegjo Marijen se shka thoshte tash per kolektivin... Edhe ajo don...

DAMJANI: E dij. Edhe Stojani e ka kuptuem ma, por ata i pengon Bilbili. Po te mos ishte Bilbili — edhe Stojani me Kriston, dhe Petre Plakun do te ishin fut deri tashti ne kolektiv. Por prap do te futen. Sukseset t'ona ne pune do t'u hapin syte... Hajt bije paç fatin e bardhe...

(Ulet ne nji tavoline) Tashti deri sa asht heret na bini te hame dicka...

RISTENA: Mire thue... Sllavjanko, shif bije. (Sllavjanka hyne ne dhomen tjeter dhe kthehet shpejt me nji buke e thiken e ne doren tjeter ka nji lecke te mbledhun. Damjani fillon te presi buken dhe t'a ngjyje ne lecken... Ristena ulet Damjan, zemra me shtrengohet. Tashti do te vijne shcqet e saje dhe nuk do te gjejne asgja ne sepetet.. Vetem me nji jorgan po e martojme vajzen. (fshin lotet).

DAMJANI: pusho... mos qaj. Mos me deshpro dhe mua.. zemer... gjanin... Edhe ma vone mundet... per eilin do te punojme mbas sodit?.. Prap per ate...

RISTENA: Me vjen turp... Edhe ajo do te turpnohet, a mua do te me dhimset...

DAMJANI: Pse, te te dhimset... a per kete gja te dhimset, — te mos jet per tjeter gja a per kete...

RISTENA: Nuk kam pse per tjeter gja... Do te ja japim tamam si molle te kuqe...

DAMJANI: Ajo asht e randesishme... Sa per te tjerat, — te gjithe na dijne. Njerez te vorfen kaq munden. Fati asht i mire.... Kjo gja le te gezoje...

RISTENA: Marija donte t'i jepte toke, por Stojani...

DAMJANI: Kane ata toke... Edhe ma te madhe se sa te Stojanit... Kolektivi te jete gjalle... Mijra hektare toke i presin per pune...

RISTENA: Si thue ti? A ti fus ne sepete çorapet laramane qe i kam prueun per paje? Ashtu asht zakoni... keshtu duhet...

DAMJANI: Pse me pyet mue?... Jep gjithe shka kemi.. Zemra e me asht plot e perplot.

RISTENA: Ça kemi neve tjeter gja?

DAMJANI: Kemi dueret...Kemi shendetin...Kemi dashunine ndermjet njerzvet... Shka don ti tjeter gja?.. E-ee, — te kem un vajze si Sllavjanka — edhe dhander si ky qe po me vjen... E shef se sa e çmojne shoket e tije!... Kush

tjeter asht ftuem keshtu prej shokvet, ti pregatisin sofren dhe ta presin per dasem? Edhe kete e ban katund tjeter!... I gjithe Novo-Sello do te mblidhet tash per ate!... Do me thane se e çmojne. A nuk te gezon kjo gja?...

RISTENA: E si jo... Gezohem. Por pse kshtu, Damjan, zemra m'asht e ndrydhun dhe nuk po mund ta hap e te gezohem...

DAMJANI: Pse? edhe un nuk e dij... Ndoshta per shkak se nuk jemi mesuem te gezohemi... Por ti lshoje zemren... Kjo nuk asht anderr. Kjo asht e vertete... dhe gezohu.!..

(Sllavjanka bije luge dhe sende te tjera... Ristena ngrihet ta presi).

RISTENA: Shtjeri moj bije... Shtjera moj bije babes prej rakis se tezes...

(Sllavjanka mbush nji gote dhe ja jep te jatit. Damjani merr goten por ende nuk pije)

DAMJANI: Hajde bije... Tash shtjeri babes per te fundit here si vajze... Dhe mos me turpno edhe atje...

(Qit shamine prej brezit dhe meshine lotet, por prap e merr vedin shpejt)... Mbushi nji gote edhe nanes... Keshtu asht kjo bote... Femija vajze... E ushqen, e rrit — per shtepi tjeter... (Sllavjanka i bije raki dhe s'ames).

Hajt qofsh e lumtun dhe me fat te bardhe bije.. (pi) Un tashti nuk munda te te japi kurrgja, sikurse u jepet nusevet prej babes.. Por... do ta plotsojme ma vone kete detyre... T'i prap ie e jona. Un me nanen t'ande per cilin do te punojme?... Prap se prap per ty... Eh si do ta kalojme neve me dhandrin... Ai asht djale i mire... As kujt nuk ja len hakun — por edhe shpirtin e ka shum te mire.

(Ne rruge ndegjohet nji shamate, ndegjohen zane femnash, mbas pak zanet afrohen afer shtepise, prane portes ndegjohen kange dasmore).

SLLAVJANKA: Nane po vijne! . .(e shikon tamen drejte ne sy).

RISTENA: Tashti bije. . (Te dyja me te shpejte mbledhin shka kishin ne mase dhe afrohen afer portes, kurse Damjani hap porten.

Vajzat kendojne perjashta:

Blij mor krushk nusen
E shtrejte asht nusja edhe e vlefsheme
Blij nuse krushk
Blij vajzen prej nanes. . .

Sllavjanka shef t'amen dhe me njihere i bije ne kraha. E ama e perkedhel neper floke dhe meshine lotet e vet).

RISTENA: Mos qaje bija nanes. . . Edhe, mue keshtu me ngjau. . . Edhe gjitha te tjerat po keshtu do te shkojne. . . Mbassi pushon kanga futen ne shtepi 5—7 vajza dhe po aq djelmosha beqare. Vajzat — shoqe te nuses, kurse djemt jane shoke te dhandrrit. Me ata asht edhe kunati, i cili mban nji flamur ne majen e te cilit ka lidhun dy shamija, kurse ne kulm ka vue nji molle te bukur. . . Ne doren e majte ka nji bucele te vogel me vene te mbledhun me nji shami te bardhe. Kunati hyn i pari. . .

I dyti hyne Byrazeri, i cili per rreth krahut e poshte ka lidhun nji shami te gjate te bardhe dhe ne krahnuer ka vendosun nji lule t'argjente. Gjithashtu edhe Byrazeri ka nji shishe rakije, te mbeshtjellun me shami te bardhe, kurse ne doren tjeter ka nji tepsi me nji pule te zime dhe buke.

Te gjitha vajzat mbajne nga nji send prej rrobevet me te cilat do te mveshin nusen e re.

Te gjithe hyjne me zhurem, te gezuem dhe te lumtun. . .

KUNATI: Miremengjez krushku Damjan. . Ja, ma erdhem. . . na doni a po s'na doni? . .

DAMJANI: Mire se erdhet kunat. Ju duem... Urdhnoni... Mire se erdhet Byrazer... Urdhnoni... (i udheheq krushqit)... Uluni... Do te na falni se jemi pak ngushte...

KUNATI: Ka vend... Ka vend, krushk Damjan...

BYRAZERI: Kur do te shkojme ne shtepine kooperative, atje atehere do te jemi ma gjanisht . . . Tashti do te durojme edhe...

DAMJANI: Edhe ajo do te bahet... Edhe dasmat do t'i bajme ne bahçe...Po tashti ne qofte se keni qejf te kceni do te dalim ne rruge...

KUNATI: Do te kcejme ne Novo-sello... Ketu do te ngutemi pak...

BYRAZERI: Hajde ti Trajanka ngutuni pak ne punen t'uej... (Vajzat terhiqen ne nji qosh, Damjani me Byrazerin shkojne nga minderi, kurse kunati me beqaret shkojne afer tavolinavet neper karrike. Kunati len flamurin afer oxhakut. Te gjitha vajzat pershendeten me Ristenen dhe Sllavjanken, te cilat i ftojne te shkojne me ta.)

DAMJANI: Urdhno Byrazer... Ulu ti ketu... Un do te rrije ne kambe...

BYRAZERI: Jo, jo, ulu ti krushk Damjan, un po rrije ne kambe... (Damjani ulet. Ristena i rrin drejte prane tije.

Kur vajzat e tjera ulun. Trajanka me Tamjanken qendrojne ne kambe tue pasun ne dore (hopa) dhuratat — fustanin e nuses etjera, kurse para tyne qendron Sllavjanka. Te gjithe veshtrojne nga vajzat. Kur ne fund te gjithe heştin atehere Trajanka i drejtohet Sllavjankes e i thote):

TRAJANKA: Sllavjanke hajde te te veshim...

TEMJANKA: Jo keshtu moj Trajanke!

(te dyja qeshin me te madhe)

TRAJANKA: Verte mire e ke...

BYRAZERI: Moj shka jeni tue bamun juve? . . . Do te na merrni ftyren. . .

(Trajanka dhe Temjanka bashke me dhuratat ne dore shkojne ke Byrazeri. I bajne me shenje qe ai te shkoi ke ato. Ai shkon n'anen tjeter ke vajzat. Te gjithe kthehen 'kah Damjani).

TAMJANKA: Krushke Ristena. . . Ulu edhe ti afer te zotit te shtepise.

RISTENA: Mire jam un Temjane. Un Jo te qendroj keshtu ne kambe. . .

DAMJANI: Ulu, ulu, moj amvise. Keshtu asht zakoni... (Ristena ulet).

TRAJANKA: Ju lumt krushq se keni rritun vajze qe s'e ka shoqen. . . ma e lehte se era, prej diellit pa nximun. . . A pranoni ta bajme nuse per djalin t'one asllan. . .

TEMJANKA: Si asllan rrin neper oborre, kalin e ka te shqetsuem. . .

BYRAZERI: Briskun e ka ne brez. . .

TEMJANA: Me neve haber ju bije dhe na haber do t'i çojme. . .

KUNATI: Deri tashti vajza ishte e jueja, — kurse prej tash — do te jete e jona. . .

(Temjana dhe Trajanka perkulen pak per me nderuem):

DAMJANI: Mire se ke ardhen kunat. . . edhe ti byrazer . . . Un nuk e dij mire adetet, por hallall ju qofte. . . Un ju a japi me gjithe zemer — dhe ju kryenja adetin. . .

(Te gjithe qeshin. Trajanka me Temjanen ndahen prej grupit dhe shkojne ke Sllavjanka. Prej atje te gjitha vajzat shkojne per ne dhomen e mbrendeshme. Te parat hecin Trajanka me Temjanen me dhuratat ne dore, mbas tyne shkon Sllavjanka e mbas saje te gjitha vajzat e tjera. Kenojne dhe kanga fillon ne ulet ne dhome. . .

Mbas kujt je nisun bukuroshe
A mbas vllajt — a mbas kushurinit. . ?
Aj moj nuk asht vllau i yt,
Por ai asht djal i tjeter kujt! . . .

KUNATI: Mire the ti krushk Damjan. . . Shka jane te gjitha keto marifetlluqe. . .

DAMJANI: Adete. . . I kam harrue, prandaj e shkurtova keshtu.

BYRAZERI: Hajde tashti edhe un ta baj adetin. . .Shum shendet ke prej krushkes. . . Ja raki te ka dergue. . .

(Shishen e rakise e ven ne sofer).

Urdhno! . . . Pi — merre ti çojme haber edhe atyne. . .

(Damjani pije prej shishes dhe e ven perseri ne sofer. Ristena ngrihet dhe merr prej oxhakut poshte nji shishe gjithashtu te mbeshtjellun me shami te bardhe dhe i a jep Damjanit. Ajo qendron ne kambe. Damjani kur pijen ne shishe dhe perpara se me pimun i drejtohet Byrazerit)

DAMJANI: Ajde paçi ardhun me kambe te mbare. . . Mire se erdhet. . . (Merr prej Ristenes shishen edhe i a jep Byrazerit): Ja, çonja kete krushkes. . . te vije bashke me krushkun dhe me dhanrrin. . .

(Kunati merr shishen prej Byrazerit dhe i drejtohet beqarvet):

KUNATI: Pere. . . hajt vrapo deri ne shtepi. . .

(Pera shkon e merr shishen, por Kunati ndalet). . More dhe pa kete shishe mundet. . . Vrapo t'i thuesh te vijne sà ma shpejt, pse do te vonohemi. . .

RISTENA? Jepja shishen, jepja krushk. . Keshtu asht zakoni. . .

KUNATI: Eh moj krushke. . . Mundet edhe pa keto adete. . .

BYRAZERI: Jepja ti shishen Peros... zakoni asht zakon

KUNATI: E, hajde, na... Vrapo (Pero del perjashta; Damjani dhe Ristena e percjellin. Prej porte Ristena shkon ke Sllavjanka, kurse Damjani kthehet prap ne minder. Kunati merr gotat e rakis prej mases dhe shkon kah Damjani per me i mbushun nga shishja)...

DAMJANI: Nuk asht keq t'i dijme adetet dhe t'i ruejme... Un jam njeri poljak, verte, por edhe un kam kuptuem diçka... Me çfar njerzish nuk kam folun atje ne bregun e Vardarit... Me fotografen, gazetare, — edhe me asish qe shkruejne libra... Ulu afer meje Byrazer...

BYRAZERI Nuk ban.. Puna e ime sot asht keshtu — te mos ulem.

DAMJANI: Nji piktor me vizatoi me bojna gati nji jave te tane, edhe mbas meje te gjithe fushen... „Ruejtesi i pasunis popullore..." Edhe ai me thoshte — „Shka ka krijuem populli — te gjitha jane te mira... Edhe adetet.. edhe kanget e vjetra, edhe gojdhanat... Prej tyne ka se shka te mesohet. Na duhet t'i ruejme..." Ata e kane bashkuem te gjithe popullin si nji...

KUNATI: Ashtu qofte, — por ja — Sllavjanka te gjithe veren prej eres asht rrafun, prej diellit asht djegun dhe deri ne palce i ka hymun shiu, — kurse kanga te thote: — As dielli nuk e ka nximun"...

BYRAZERI: Ashtu thote, qe te tregohet se sa e bukur asht vajza...

KUNATI: Hajde qofshin te lumtun... (I jep raki Damjanit, Byrazerit edhe beqarvet. Beqaret pershendesin „Qofshin te lumtun" edhe pijne).

DAMJANI: Njefshim edhe ne juve. edhe ne koken t'uej.

(Kunati merr pulen e zime dhe buken qe Byrazeri ka ne fer. Bucelen e venes e len ne sargine afer sofres).

KUNATI: Urdhno krushku Damjan... Kjo asht prej meje, prej kunatit te vogel...

DAMJANI: Te falem nderes kunat... Hajt tash mbushi gotat beqarvet nga vena e jone, prej rakis s'one... (Kunati shkon ke beqaret u mbush gotat me raki dhe me vene edhe ai vete mbetet e rri me ata. Prej mbrenda ndegjohet kanga e vajzavet. Kur fillon kanga Trajanka dhe Tamjana e hapin porten dhe qisin nusen te nderrueme. Vajzat kendojne:

— Mos hyp ne kal te huej moj vajze.
Kal i huej — mallengjim i madh..
Mos shko ne shtepi te huej vajze...
Shtepija e huej — mallengjim i madh
Mos merr nane tjeter vajze
Nana tjeter — mallengjim i madh"...

Kunati shkon ke nusja dhe i jep pare, ajo i puth doren. Vajzat kendojne:

Mos qaje nuse oh mos qaje
Mos i prish syte e tuej me vaj
Se je i bukur si trandafili
Zani i yt i ambel si bilbili
Mos qaje mos e prish bukurine
Ty te pret nji pullumb i ri
Si larosh e vetull zi...

(Ristena ngadale fillon te qaje dhe meshine lotet here me shami here me perparjen).

Ngadale ajo shkon e ulet ke Damjani, Kunati qit nji pale kepuce te reja dhe vete i a mvesh nuses, e cila ishte ne çorape.

Vajzat kendojne:

Vajze e re moj bukuroshe
Nuse sot te bajme sy laroshe...

(Burazeri shkon i ven nuses nji kunore prej fletesh rrushi ne krye. E rregullon ai vete, vajzat vazhdojne kangen:

Floket e tuj po t'i ndreqin
Qe i ke porsi mendafsh
Prej goje mos qit afsh
Moj vajze sy laroshe...
Se ata po t'zbukurojne
Me kunor t'bukur dhe me kunore mali...

(Hyjne Marija dhe i shoqi, Stojani. Marija asht e gezueme dhe ka ne dore nji bohçe te madhe, kurse Stojani heshten dhe ka nji binlluk me vene, te lidhun me shami te bardhe.

Ristena e gezueme shkon kah Marija, por Marija kur shef Sllavjanken se asht bamun nuse, shkon ke ajo dhe i ven bofçen perpara kombevet. Sllavjanka i puth doren, Marija e puth dhe kthehet ne vend me syt e perlotuem. Damjani ngrihet per me i pritun.

DAMJANI: Mire se me erdhe Stojan...

STOJANI: Mire se te gjeta...

Eh Marije... Hajde mire se ke ardhun... Ti edhe ma teper ma gezove shtepine... Hajde te ulesh ketu afer baxhanakut...

DAMJANI: Eh tashti e kam zemren plot... Eja.. ulu..

MARIJA: ulu ti atje... atje asht vendi i jot...

DAMJANI: Ulu... ulu...

(Te dy ulen ne mindenin. Ristena bije nji shkam te vogel, te cilin e vendos afer Stojanit. Stojani ulet. Ristena rri afer Marijes, Vajzat kendojne:

„Ej ti moj gonxhe trandafili
Deri sa ne kopesht dy konxhe çelin
Njena lulzon tjetra po vyshket...
Ajo qe lulzon asht nane e djalit
Djalin rrit dhe e gzueme asht
Ajo qe vyshket — asht nane e vajzes
Vajze rrit por e gzueme s'asht...

Hyjne te dasmoret: Vjehrra, kumbari me kumbaren, dhandorri me kunatin ma te madh dhe me kunaten dhe Pero...

Damjani, Ristena dhe Marija i presin. Po ashtu edhe Stojani çohet ne kambe. Vjehrren, kumbarin dhe kumbaren i ulin ne minderin...

DAMJANI: Mire se erdhe kumbare, mire se erdhe krushke... urdhnoni...

MARIJA DHE RISTENA: Urdhnoni... Urdhnoni... Mire se keni ardhun...

UMBARI: Mire se ju gjetem, krushken... A na pritni per te mire e gezim..?

MARIJA: Per te mire e per gezim kumbare.. Me hajer qofte... Patçin fatin e mire e jete te lumtun...

KUMBARI: Atehere ju qofte me jete e ymer dhe fat dhandri...

DAMJANI: Njefshin edhe ne djemt e vajzat t'ueja kumbar...

MARIJA: Edhe per femijet t'uej kumbare... Uluni... ...Mire se na ke ardhun krushke...

(Pershendetet me krushken tue i dhanun doren) Te qofte me kambe te mbare nusja... Ju zbardhofte e gezofte shtepine...

VJEHRA: (Krushka): Hajt per te mire e me fat te bardhe, Marije...

(Ulen. Marija ulet afer kumbares. Stojani asht ulun ne shkambin e vogel, kurse Damjani e Ristena qendrojne ne kambe ne te dyja anet e miqvet.

Kunati dhe kunata rrin ne pjesen e pare te mases. Dhanri rrin ne anen e djathte te skennes dhe hesht deri ne fund.

Vajzat kendojne:

„Mire se erdhet — darsmore te bardhe
Mire se erdhet — mire se u ulet
A keni prue — shka kemi folun?
Nji kilo grune — edhe elb
Mish te zimun — edhe raki t'pjekun? . . .

(Kunati i math zgidh pogaçen qe e ka prue — t'ashtu quejtuen pogaçen „darsmoreja", e cila asht pogaçe qe bahet vetem neper martesa, e ven ne sofer afer Damjanit, ne toke elb, leblebi dhe dhe me pare te vogla.

Ne te njejten kohe perjashta ndigjohet zhurma e kolve edhe zani i karrocjerit. . . Truuu!. . . . Damjani, byrazeri ven nji bucele me vene. Kumbari ven ne toke nji torbe dhe kunati i ri shkojne nga dera, kurse ne te njejten kohe hyjne ne dhome kryetari i kooperatives dhe tre kater antare te keshillit drejtues te kooperatives).

KRYETARI: Mire mengjez, mixha Damjan. . . Ja. . . Edhe neve erdhem mbas nuses. . Mir mengjezi byrazer Edhe ty mor kunat. . .

DAMJANI: Mire se erdhet shok kryetar. Jam shum i lumtun qe na vizituet. . .

BYRAZERI: dhe kunati po ashtu e pershendetin kryetarin edhe shoket e tije .

KRYETARI: Si mos te ju vizitojme. . . Pse a nuk jemi tash te gjithe nji. . .

DAMJANI: Ashtu asht shoku kryetar. . . Urdhnoni. . . (fton te rrijne ne mase. Ergenet ulen ne banken, kurse krye-

tari me miqt e tjere ulet ne tavoline. Kryetari gjithashtu mban nji bucele ne shami te bardhe dhe e ven perpara vedit ne tavoline.)

KRYETARI Eh ja de... Mire mengjez te gjitheve — qofte me hajer gezimi... Edhe ty mixha Stojane... Edhe ty kumbare...

KUMBARI: Mire se erdhet shoku kryetar...

KRYETARI: E, ti byrazer si keshtu, a nuk ka vend per ty?... Hajde ketu ke un...

BYRAZERI: Sot keshtu asht puna e ime... Te rrij ne kambe dhe te rregullloj te tjeret...

KRYETARI: Edhe ketu te rregullojsh te tjeret?...

BYRAZERI: Keshtu na ngjau edhe sot...

KRYETARI: Si a nuk jeni bamun ende gati?... Prej Novo-selles filluen te pyesin se kur do te niseni...

BYRAZERI: Presim t'i mbarojme adetet, pastaj do te nisemi shoku kryetar.

KRYETARI: Ashtu... Te mos vonohemi shum... Trajanka a mbaruet ju pune...? A e rregullut e zbukuruet nusen?...

(Trajanka qesh si e turpnueme).

BYRAZERI: Ato jane gati, por si thame duhet ta bajme deri ne fund adetin... Krushku Damjan ka vetem nji vajze...

KRYETARI: Mire e keni: Zakonet e popullit jane gja e mire... Ata na kane ruejtun gjate shekujvet te robnis — edhe neve duhet t'i çmojme... Dhe do t'i shtojme nga diçka nga jeta e re — dhe jeten do ta çojme me ata...

(hyne karrocjeri, Gligori).

GLIGORI: Shok kryetar ku do t'i shkarkojme plaçkat?

KRYETARI: Ketu... Ketu... Shkarkoni edhe pritni pastaj...

(Gligori therret disa prej beqarvet edhe del bashke me ata. Kunati i jep miqvet raki. Ata pijne tue thane per shendetin e te martuemvet — kurse Damjani dhe Byrazeri u pergjigjen — shendet patçi).

KRYETARI: Edhe per shendetin tand po themi Vojdan.

(Vojdani — dhanderri — heshten).

Ti... shka ke... a je bamun memec...?

BYRAZERI: Aj heshten perpara vjehrrit shok kryetar.

KRYTARI: Dhe me te vertete duhet te heshti jo vetem perpara vjehrrit, por edhe perpara vjehres, Ristenes, qe i ka rritun e lindun kesish vajze... A e shef se çfar nusje asht Sllavjanka!... Kesish si ajo nuk gjinden shpesh here...

BYRAZERI: Do te heshti edhe perpara meje, pse deri ne mbramje un e kam fjalen... se po gaboje tjeter kujt do te ja japi fullanxen...

KRYETARI: Po hajde shoqe mbaromja adetin, por rueni forca edhe per atje...

(Vajzat veshtrohen, pyesin njena tjetren dhe kendojne:)

Vjehrro moj e bardhe — ku e ke gjylpanen e arte? (Vjehrra shkon edhe i ven ne krye nuses nji gjylpane me lule te bukura ari, ase argjenti. Nusja i puth doren. Porsa vjehrra fillon te hiki vajzat kendojne:)

Po ku e ke fustanin prej mundafshi, po ku e ke xhyben prej sateni?..

Vjehrra shkon ke kunata dhe merr prej saje nji fustan dhe xhyben dhe i ven ne krahat e nuses. Trajanka dhe Temjanka e vejne ne bohçen e Marijes. Nusja i puth doren. Vjehrra shkon ne vendin e pare.)

Vajza kendojne:

„Vjehrre — moj vjehrre e bardhe
Po ku e ke fustanin e bardhe?

(Vjehrra ven nji fustan te bardhe ne krah te nuses dhe e puth

Vajzat e vejne ne bohçe edhe pastaj te gjithe sendet qe ka ne bohçe i a japin beqarvet, te cilet i vejne mbrapa.

Mbasandej ftojne byrazerin dhe kunatin ta marrin nusen. Ata i vihen ne te dyja anet. E çojne ke e ama dhe i jati dhe vajzat kendojne:

Lulzoje nji vjollce
Ne mes te barzilokesh
Ajo nuk ishte vjollce
Ne mes te borzilokesh
Por ishte nuse e re
Ne mes te dy kunetesh t'ri...

Kuneten e vejne nusen perpara nanes e babes se vet, kumbarit, vjehres edhe te tjervet...

Vajzat shkojne ne te dyja anet ne dy grupe dhe kendojne kangen e ndamjes:

Qershija prej rranjesh shkelesh
Vajza prej nanes po ndahesh, —
Prej nanes e babes plak...
Edhe ndahet e me mall qane
Prej gjijvet te babes asht ndame
Krahnorin e nanes me lot e lane...
— Si do te therres nane tjeter — „nan
Nane nuk e kam, nane do t'i them
— Un do t'i them — ajo „bije" me therret...

(Ristena qan pa pushuem. Qane edhe Marija... Te gjithe te tjeret qajne kush ma pak e kush ma shume... Bile edhe Stojani meshine lotet... Po ashtu edhe nusja qane edhe nuk e hek shamine prej syvet, tue meshimun lotet...

KRYETARI: Shka ju duhesh keto kange te mallengjyeshme... I mallengjyet te gjithe... kurse neve jemi mbledhun per gezim e hare... Shif Temjanke a nuk dini ndonji kange ma te gezueshme. A nuk ka ndonji kange tjeter, ne te cilen kendohet se miqt japin dhurata (peshqeshe)?.. (Vajzat qeshin..)

TAMJANA: Kesish kange nuk dijme shok kryetar...

KRYETARI: Eh, un do te ju kendoj kesish kange.. Bile te gezueme dhe te mos i mallengjej prindet dhe njerzit e tjere...(Ngrihet) Gligor!.

GLIGORI: (I mbeshtetun ne porte) Ketu jam shok kryetar, urdhno.

KRYETARI: Hajde ketu. (Gligori shkon, kryetari i jep nji gote raki edhe cokrrit goten e tije me te veten).. Pi.. te bafte mire...! (Pijne te dy)... Ti a din te kendojsh?...

GLIGORI: Dij diçka ,por kange qe duhen kenduem perpara kumbarit nuk dij.

KRYETARI: Ashtu thue? Por shif njihere si do te mesoj un te kendojsh edhe perpara nuses... Pero ndifmoje Gligorin ...Binja bohçen...

(Gligori del dhe mbas tij Petri me disa te tjere bijne nji bohçe te madhe. Gligori e ven perpara nuses).

KRYETARI: Hapi Gligor.

(Gligori hap bohçen e cila asht plot me tesha te mbrendeshme te rregullueme mire. Gligori mbassi e hap kthehet ka kryetari dhe i flet)

GLIGORI: Urdhno shoku kryetar.

KRYETARI: Nuse, te bije keto kemisha burri dhe gruje dhe çarçafe per jorgane dhe dysheke...

Kolektivi e ka qepun kete paje per ty, atehere kur ti punoje, korrje e mblidhje frytet e punes neper fushat e prones se tij, do me thane te prones s'one te pergjitheshme (Ven nji kemishe ne krahat e nuses, kurse te tjerat i jep Gligorit,

qe i vendos ne bohçen. Vajzat e marrin kemishen prej krahut te nuses, e vejne edhe ate ne bohçe e te cilen e vendosin mbrapa. Sllavjanka shikon e habitun dhe e prekun fillon te qaje pa i meshimun lotet — shikon kryetarin)....

BYRAZERI: Mbahu mori... A keshtu do te na jeshe me vaje gjithnji ne buze?... Shife ate qe heŝht atje n'anen tjeter, atij nuk i pelqejne ato qe qane!...

(Sllavjanka e shikon me mirenjoftje por prap nuk mund t'i ndali lotet dhe nuk mund te permblidhet prej habitjes dhe gezimit te madh...

Ristena asht afrue afer se motres dhe shikon here ate, here Damjanin, here Sllavjanken — dhe po ashtu qane.

Po ashtu edhe Marija meshine lotet, por mundohet t'i nenqeshi Sllavjankes...

Damjani memzi qendron ne nji vend, njihere luen nji kambe e here tjetren.

Stojani ja ka ngulun syte me çudi kryetarit).

KRYETARI: Gligur bini tashtti bohçen tjeter.

Te giithe heshtin. Qetsija asht si diçka hijnore. Gliguri bije edhe bohçen tjeter e ven si edhe ate tjetren dhe mbassi e hap i jep nji paket me fonelle kryetarit, i cili, me paketin ne dore kthehet nga nusja).

KYETARI: Per pajen tande muerem edhe keto çorape, fonelle, shkalle dhe fustane... I kemi preyatitun per ty atehere kur ju me Vojdanin fituet garat ne mbjelljet e pambukut dhe te misrit...

(e ven paketin ne bohçe)... Sikurse e shef kolektivi asht si nji babe per te gjithe... Ai kujdesohet t'i baje te lumtun antaret e vet, ashtu si baba kujdesohet per femijet e tije...

(Sllavjanka ka kafshuem buzen e poshteme dhe ka vendosun ne buze gishtin e perkulun. Ajo e shikon ne sy kryetarin i cili i nenqesh me dashni prindore... Vajzat dhe beqaret e marrin bohçen dhe e vejne mbrapa me te tjerat).

KRYETARI: Gligur tashti bini edhe plaçkat qe kane mbetun.

(Gligori dhe disa te tjere dalin perjashta)

KRYETARI: Disa qe nuk na shofin me sy të mire thone se na duem te ju bajme rob dhe argaten juve antaret e kooperatives. Kurse ju vete jeni mbrenda ne kolektiv dhe shifni çdo dite se si i don kolektivi njerzit — se si don qe me anen e punes tyne te bashkueme dhe shoqnis t'i bashkoje gjithnji ma teper... T'i mesoje njerzit te shofin njeni tjetrin ta ndifmojne kur te jete nevoja...

Edhe ne jeten e vet dyvjeçare kolektivi i jone mund te thohet se e ka mberrijtun kete gja...

Kolektivi e mberrijti kete gja vetem e vetem ne saje te punes s'uej, ne saje te perpjekjevt te te gjithe antarvet...

Dhe tashti kur t'i bie keto shperblim un due te deklaroj se shum i kenaqun asht prej teje kolektivi, per perpjekjet t'ueja qe ke qenun gjithnji shembull per te tjeret e per te tjerat...

(Gligori me te tjeret bijne nji krevet hekuri per dy veta, nji shporet, nji mase me kater karrike dhe nji sandyk me ene per te gatuem buke e gjelle. Te gjitha keta i vejne mbrapa. Kryetari kthehet nji dy hapa mbrapa dhe prej se largu i drejtohet Vojdanit):

KRYETARI: Kurse kete krevet, masen dhe sendet e tjera kolektivi t'i dhuron, ty Vojdan... Ti me punen dhe qendrimin t'and, ne te gjitha akcjonet e kolektivit ke treguem se shka asht ne gjendje te baje nji njeri. nji puntor i lire...

RISTENA: (Meshtet kryet ne krahet e Marijes e shikon ne sy dhe i thote)... Marije... a asht e vertete, a po jam n'anderr e gjithe kjo?...

MARIJA: (e veshtron e prekun dhe i pergjigjet): E vertete asht moj moter...

KRYETARI: Nanen tjeter kryesija e kolektivit t'one tue marrun para syshe se tashti ju jeni familja ma e re dhe ma e vorfen ju sjell te dyve edhe kete vendim me te cilin (qit prej xhepi vendimin dhe e hap) juve ju epet pergjithnji apartment numur nji ne shtepine e re kolektive, ne te cilen qysh prej muejit te ardhem ju lirisht mund te rregulloni keto orendi shtepijare...

Tue i u dorzuem keto dhurata un ju uroj qe edhe ma tutje te jeni gjithnji ne rradhet e para te kolektivit t'one te rij dhe te punoni me dashtuni si deri tashti per suksesin e prones s'one te re socjaliste...

(Shkon nga Sllavjanka) T'i gezoni dhuratat... Te jeni te lumtun te gjithe jeten... (I jep doren Sllavjankes per t'a uruem. Ajo ja terhjek dhe me perdhune i a puth, vazhdon t'i mbaje gjithnji doren dhe e veshtron dishka e shkuqun ne fytyre).

SLLAVJANKA: Te faleminderes shok kryetar!

(Kryetari shkon nga Vojdani)

KRYETARI: Te uroj jete te lumtun Vojdan!

VOJDANI: (I mban doren dhe e shikon drejte ne sy por prap me thjeshtesi i thote): Un... s'kam ba kurrgja ma teper ... se sa te tjeret... Pse vepruet keshtu... te turpnohem prej tyne...

KRYETARI: Prej se do te turpnohesh?... Po kjo asht e vertete. Po ashtu asht...Edhe te tjeret kane bamun sa ti... Edhe kur t'u vije rradha, kolektivi edhe ndaj tyne do te fillet keshtu — sikurse edhe me ty... ti ke fatin te jeshe i pari...

VOJDANI: Te falem nderes shoku kryetar... (i shtrengon doren me fuqi dhe veshtrohen tamam si burra, shoke te vertete. Kryetari ndahet prej tij dhe shkon ke Damjani).

(E shtyne vjehrren) Te paçin kamben e mbare moj vjehrre... Nusja te qofte me kambe te mbare e me rrisk e kismet... a e shef se me çfar fati te vjen ne shtepi?...

(Damjani nuk mund te mbahet, psherretine me fuqi, por prap mbahet edhe e permbledh vedin. Stojani e shikon shum i tronditun. Kryetari kthehet prej Vojdanit, te gjithe pa u kuptuem levizin. Dikush ngrihet ne kambe.)

KRYETARI: (Shkon ke Damjani dhe i vën doren ne sup). Po ti pse keshtu shok Damjan?

DAMJANI: Edhe un nuk e dij se shka ndoth me mue...

KRYETARI: Mbahu he burr... Un ty te njofi per burr

KRYETARI: Kurrgja...! Nji nder shperblimet ma te zakonsheme per nji nga antaret ma te vlefshem te kolektivit...

DAMJANI: Si te ju them... Te gjitha keto jane te jasht-zakonshme.

KRYETARI: Hajde... hajde... kurrgja nuk ka te çuditeshme ne kete rast...

DAMJANI: Si nuk ka... Mue... poljakun Damjan vetem me percmojshin... Un nuk mundesha ne te kaluemen te perzihem me te tjeret... Nuk kishje te drejte te flisje me ata Gjithmone heshja dhe rrijshe ne fund te sobes — dhe çdo i marre dhe i padijtun mendonte se është ma i mençem se sa un...

Kurse tashti, me njihere, ju me qitet prej baltes dhe me bate shokun t'uej, te rrije krahas me juve... Pse a pak asht kjo a?...

KRYETARI: Atehere gezohu!... Ji kryenalte... Vajza e yte asht sulmuesja ma e mire, ti je nji prej antarvet ma te vlefshem te kolektivit t'one... Na duhet te rendohemi prane teje e jo ti prane nesh, pse ti je ma i dalluem se neve...

DAMJANI: Eh shok kryetar, ta dijshe se si asht tashti ketu ne shpirte (ban sheje me dore ne gjokes)... un i urrejshe njerzit dhe largohesh prej tyne. Ata ne mue nuk shikojshin njeriun Damjan, por shifshin vetem poljakun Damjan... Ne mue ishte tue vdekun njeriu... mbetesha vetem si figure...

Por kolektivi per mue gjithnji hap nji porte sa ma te re edhe un tashti e shof jeten te bukur, te ndriteshme dhe te paster...

Ju mu drejtuet tamam si njeri i barabarte me juve... Tamam siç duhet ndaj nji njeriu. Un tashti mund te flasi me te gjithe... Dhe te gjithe i ndegjojne fjalet e mija... ja si tashti.. Do me thane se edhe un jam njeri?...

KRYETARI. Po shok Damjan.

DAMJANI: Te gjithe jeten nuk jam gezuem — kurse tashti i gjithe gezimi më vjen i tane me njihere... Dhe çdo fjale dhe çdo veshtrim i juej me duket si kur me thote: — Jeto, e gezo Damjan... Gezohu per jeten!... Dhe me te vertete un qe ma perpara i mallkojshe ditet, mallkoje diten qe kam lindun, tashti due te jetoj. Due shum te jetoj...

Te punoj!... Te perpiqem... Dhe te ndeshem me te tjeret se kush te punoje ma shum... Te ngrihem nalt — dhe te shof vedin se si dukem — si njeri i ri i ngritun mbi ate — tjetrin — poljakun — qe tash me te vertete po vdes — dhe per te cilin askush te mos me flasin e kujtoje ma...

KRYETARI: Shok Damjan.. Ti je jo vetem njeri... por me te vertete njeri shum i madh!... Ma jep doren (I shtrengon me fuqi doren dhe e veshtron me respekt dhe me dashtuni)... Ti je njeri i ri! (Askush nuk asht ma ulun, te gjithe jane ngritun njeni mbas tjetrit gjate bisedimit qe zhvillohet ne mes te kryetarit dhe te Damjanit... Po ashtu asht ngritun edhe Stojani.. Ai qit nji shami dhe meshine ballin. Don te flasi, por i shikon te dy, te cilet me ngadale leshojne doren njeni tjetrit..

Ne ate moment prap jo me vendim te premun, Stojani shkon nga ata)

STOJANI: Kryetar... Damjan...

KRYETARI: Fol mixha Stojan..

STOJANI: A doni te me ndegjoni edhe mue? Dhe te them vetem disa fjale...

KRYETARI: Fol... fol... mixha Stojan...

(Kryetari shkon ne vendin ku ishte ulun ma perparas)

STOJANI: Un e kuptova Damjanin — por — edhe ju te tjeret ju kuptova... Ate qe the ti per Damjanin — njeri i ri — ja un, Stojani — a ma due te me kuptoni... Un e them per te gjithe juve...

Por uluni... Due te uleni (Ngadale njeni mbas tjetrit ulen. Edhe Damjani ulet ne vendin e Stojanit) Un paskam qene qorr... Nuk e ndegjova Damjanin... Ne shtepi nuk e ndegjoje as Marijen...

Tashti ju mi hapet syte... E kuptova boten! E kuptova edhe shpirtin e Damjanit...

Gjithe shka tha ai asht krejt e vertete — edhe mue tash me vjen turp perpara tij...

DAMJANI: Lene tash at pune baxhanak...

STOJANI: Nuk ka pse t'a laje kete pune... Un duhet tashti te them çdo gja...

DAMJANI: Mos fol per mue...

STOJANI: Nuk ishje vetem ti, ju ishit shum... Por ju i dhate doren njeni tjetrit per me shpetuem dhe me te vertete shpetuet... Tashti mue me vjen turp te shifem si njeri, qe ka mbet ne nji ane i ndamun prej te tjervet. Un deshta ta pngoj kete jeten t'uej qe vrapon perpara porsi maqine te cilen nuk mund t'a ndali askush...

KRYETARI: Te lumt mixha Stojan... Ja e shef si erdhi rradha t'a njofesh dhe t'a pranojsh edhe ti kete gja. Kurse deri mbrame ti luhatesh dhe kundershtoje, atje ku duhet dhe ku nuk duhet.

STOJANI: E pranoj shok kryetar... Dhe jo vetem qe e pranoj por edhe ju deklaroj se asnjihere neve privatet e ndamun nuk mundeshim t'a rregullojme jeten keshtu sikurse e

keni rregulluem dhe renditun juve... Asnjihere neve nuk kemi qenun ne gjendje te krijojme kesish gezimesh dhe kesish ditesh te lumtuna — dhe dashuni kaq te madhe, sikurse ju keni mundun te krijoni ne mes tuej.

Dhe prandaj un nuk mund te gjeje asnji shkak qe te mbetem edhe ma tutje me nji ane...

DAMJANI: Baxhanak... Shka po flet?...

STOJANI: Ne çfar mund t'a mbeshtes shpresen t'ime prej tash e tutje vetem se te vij edhe un atje ku jeni edhe ju te gjithe...

(Te gjithe levizin, disa ngrihen ne kambe. Edhe kreytari ngrihet edhe shkon nga Stojani)...

STOJANI: Po shok kryetar. Do te me pranoni edhe mue... Un ju kuptova dhe deshiroj te jem me juve...

(Kryetari e shef drejte ne sy edhe i merr doren)

KRYETARI: Mixha Stojan — momenti kur me flet vendi dhe njerzit perpara te cilvet i thue keto fjale, me detyroj-ne te te besoj... Por, prap se prap per keto pune ti duhet te mendojsh ma mire ne shtepi — pastaj te vendosesh...

STOJANI: Nuk ka se shka te mndoj shok kryetar...

MARIJA: (e veshtron tue e aprovuem) Un pajtohem me kete qe thote Stojani

STOJANI: Ne shtepi, s'kam ç'ka me mendue ma... Une pashe — dhe vendosa ... Keni, shiqoj, por njerez prej pushtetit? ç

BYRAZERI: Ja pra — un jam.. Edhe kryetari edhe kunati... te gjithe jemi ketu...

STOJANI: Atehere shkrueni... Un due me ndergjegje te paster dhe me vullnetin ma te mire... Marije...!

MARIJA: Ban shka te dijshe me zemer te hapet...

STOJANI: Token qe e kam...

BYRAZERI: Fol ti lirisht Mixha Stojan... Nuk ka pse te shkruejme ketu... Porsa flet perpara e thanme e bame... Neser do t'a shkruejme zyrtarisht...

STOJANI: (Shkon nga nusja) — Sllovjanko... Edhe un due te te uroj... Un nuk kam femine t'em — edhe ty un me tezen tande te kemi dashtun tamam si bijen t'one...

Aren e vogel me bahçen — afer Vardarit... ajo asht nji hektar... T'a dhuroj si peshqesh per martesen tande... Prej sot t'a punojsh me fat dhe me gezim (edhe e puth ne balle, nusja i puth doren Stojani i prekun dhe i tronditun shkon nga dhanderri)... edhe ty dhander te qofte me rrisk e kismet martesa... Un kam çifte kual... Kualt e ri me karrocen t'i dhuroj ty... I gezofsh me jete e lumtuni prej sot e tutje... (Edhe ate e puth ne balle, dhanri i puth doren...)

(Stojani shkon nga kryetari)... afer ares qe i dhurova Sllavjankes asht ara tjeter e ime prej dy hektaresh... Kete toke e mbaje per vedi dhe per Damjanin bashke me nji pale qe edhe rjizet krene dhen...

Dymbedhet hektaret e tjere bashke me te gjithe bagtite dhe veglat e tjera bujqesore i fus ne kooperative — dhe ju lutem te me pranoni si antar te kolektivit...

Ja, un po te jap doren dhe deshiroj te jem me juve.

KRYETARI: Mixha Stojan, un t'a pranoj doren dhe te besoj. Por tashti nuk mund te vendosim per pranimin t'and si antar, por n'emnin t'im te deklaroj se do te pranojme. Kjo qe ban ti per neve asht mburrje dhe krenari... Asht nji fakt i paçlyeshem se neve jemi ne rrugen e drejte — dhe se vepra e jone do te fitoje...

STOJANI: Do te fitoje shok kryetar... ju keni vendosun nji rend te tille vllaznuer, nji shoqni te tille — qe askush nuk mund te na largoje prej kesaje rruge...

KRYETARI: Ky asht sistemi i jone socjalist... Dhe kur neve flasim se duem te krijojme nji t'ardhme ma te mire dhe

ma te lumtun. atehere duhet t'a dini se me te vertete na e deshirojme t'a mberijme: vllaznimin dhe bashkimin e popullit dhe sigurimin per te gjithe...

STOJANI: Ajo do te bahet... Un e shof jeten t'uej — dhe ajo do te fitoje. Keto pasuna qe kemi neve na kishin hymun se tepermi ne zemrat t'ona dhe asht shum veshtire te shkulet prej andej... Pon me lehtesine me te cilen ju i punoni keto pasunina, me t'ardhunat ma te medhaja, me perparimin e punes se juej te perbashket, ne bashkimin t'uej dhe me maredhanjet e mira ne mes jush... ju do te bani ashtu qe te gjithe ata qe jane si njeni mbas tjetrit te vijne ke juve...

KRYETARI: Shoke duhet t'i çmojme drejte dhe si duhet vepren dhe keto fjale te mixhes Stojan... Ato jane fitorja e jone dhe jane rezultat i suksesevet t'ona, sikurse i paraqiti ai vete...

Un ju lutemi t'a falenderojme per ate qe bani — dhe te pijme per shendetin e tij...

STOJANI: Jo!.. Jo per mue shok kryetar... Do te pijme per ty... edhe per Damjanin ...

(Shkon nga Damjani dhe i jep doren) Un ishje fajtor perpara teje...

DAMJANI: Nuk ke bamun asnji gabim ndaj meje baxhanak... Edhe sikurse te kishje bamun ti vete e ndreqe... Te faleminderit...

STOJANI: Prej sot na te dy nuk jemi ma vetem baxhanake... Prej sot na jemi edhe shoke — bile shoke shum te mire...

DAMJANI: Ashtu qofte baxhanak...!

STOJANI: Merre tash binllukun dhe mbushi gotat darsmorvet prej venes s'ime.

DAMJANI: Kunat... (Kunati, Pero dhe te tjeret sherbejne e mbushin gotat e te gjithe darsmorvet prej venes se Stojanit dhe prej venes tjeter qe ka aty).

KRYETARI: Mixha Stojan, — edhe prej tash e tutje ti per neve do te mbetesh prap mixha Stojan, — por prej ketij momenti me lejo te te drejtohem e te them shok i jone dhe te te uroj jeten e re, ne te cilen po futesh...

STOJANI: Edhe un keshtu due... Prej ketij momenti te me konsideroni si shokun t'uej...

KRYETARI: (E çon qe te ulet) Uhu... Ti je burr i kaluem — dhe duhet t'ulesh...

(Gjate kesaje kohe Marija asht e tronditun shum. Damjani shkon ke ajo).

DAMJANI: Ej Marije!... A te kenaq zemra?

MARIJA: M'asht bamun sa nji mal prej gezimi, Damjan.

DAMJANI: Me te vertete... Ristena na e harruem Sllavjanken).

STOJANI: (Mbasi ka marrun goten qe i dha kunati thote): Hajde tashti shoke — darsmora... T'e pijme per shendetin t'and mixha Stojan!

BYRAZERI: Edhe per shendetin t'and mixha Stojan!

KUMBARI: T'i lagim dhuratat e te martuemvet... Ti mbajne me shendet dhe me gezim... Te rrojne te lumtun dhe fatbardhe ne shtepine e re...

KRYETARI: Me shndet shoke!... Rrofte vepra e kolektivit... (Te gjithe pijne).

BYRAZERI: Shoke un mendoj se tash ma jemi gati te nisemi per rruge...

KUNATI: Fjalen e ka kumbari...

BYRAZERI: Po, po... Kumbari te marri nusen.

KUMBARI: (Shkon nga dhanderi). — Kumbar jepi fund ma heshtjes... Po t'a falim ma... Tashti ti ke jo vetem nuse por edhe kual dhe karrocen t'ande... Hajde shko e mbrehi kualt ne karroce dhe te na çojsh me mixhen Stojan ne Novo-sello... Hajde ma puth doren dhe vrapo... (Dhanderi i puth doren por qendron prap ne vend).

KRYETARI: (Ngrihet po ashtu vepron edhe Stojani): Mixha Stojan do te vije ne karrocen t'eme, kurse ty dhe Mixhen Damjan asht ma me vend te ju marni dhanderi...

KUMBARI: Mire po thue ti — ne karrocen e dhanderit te shkojme ne dasem...

Hajde kumbare ban shka duhet te bajsh... (Kumbara merr shamine me elb dhe me Kumbarin shkon nga nusja. Vajzat i mbulojne fytyren nuses. Byrazeri gjithashtu shkon nga nusja.. Kunati merr flamurin. Dhanderi shkon afer kumbares, e cila e afron nusen afer dhanderit. Vajzat kendojne, kurse kumbara hudh mbi koken e te martuemvet elb me para t'imta, sheqerna me leblebi...

Femijet dhe vajzat e vogla ngarendin e perulen se kush e kush te marri pare edhe leblebija e sheqerna.

Byrazeri merr nusen, kurse dhanderi kap perkrahu kumbaren dhe shkon mbas nuses...

Vajzat kendojne dersa dalin te gjithe dhe vete dalin te fundit... para se te dalin mbarojne kete kange:

„Hudh kumbare elb t'arte,
Ti e hudh ai jelberon
Nusja neper unaze e mblidhte
Kalin e kumbares t'ushqente...
Hudh kumbare elb t'arte
Ti e hudh ai gjelberon
Nusja neper unaze e mblidhte
Kalin e darsmorit qe t'ushqente...

(Tashti dalin edhe vajzat)